

VENDIM
Nr. 588, datë 10.9.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 12, DATË 6.1.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QAFËTHANË - LIN - POGRADEEC, LOTI I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 12, datë 6.1.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 6 017 (gjashtë mijë e shtatëmbëdhjetë) m², tokë arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 1 590 293.1 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre pikë një) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 652 500 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet përkatësisht:

a) Vlera 1 371 981.3 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë tre) nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”;

b) Vlera 218 311.8 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë tetë) lekë nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura” (detyrimet e infrastrukturës).”.

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, të shtohet nënndarja sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE, QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "QAFË
THANË-LIN-POGRADEĆ" LOTI I(SHTESAT)

[illegible]